

 RecyclART

Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union



IEK  
Αγρινίου



Asociația pentru Educația  
și Dezvoltare Durabilă



Promimpresa



IEK  
Αγρινίου



Asociația pentru Educația  
și Dezvoltare Durabilă



Promimpresa

# Hyrje

Ky Manual synon kryesisht të mbështese Trajnerët e të Rriturve në zhvillimin e rrugëve të përmirësimit e aftësive për individëd e papunësuar afatgjatë përmes krijimtarisë dhe artit.

Kreativiteti dhe artet zgjerojnë aftësinë për të bashkëvepruar me botën dhe ofrojnë një grup të ri aftësish për vetë-shprehje, mirëkuptim dhe komunikim. Kjo mund të jetë gjithashtu e vlefshme për të rriturit e papunë afatgjatë, të cilët duhet të jenë në gjendje të marrin një perspektivë të re mbi rrethanat e tyre dhe të nxiten të zhvillojnë zgjidhje alternative në lidhje me realizimin e tyre profesional. Dhe këtu hyn në lojë metodologjia Arti i Riciklimit

## Riciklimi Kreativ i Projektuar

Riciklimi kreativ i Projektuar mund të shihet si një qasje e ndryshme ndaj

riciklimit; pikënisja nuk janë mbetjet, por nevoja nga e cila lind ideja e riciklimit.

Rrjedha shkon si më poshtë:

NEVOJA → PROJEKTI → MBETJA → OBJEKT I RI

Në të njëjtën mënyrë, të papunët afatgjatë kanë nevojë për të gjetur mundësi të reja pune.

Duke u nisur nga kjo NEVOJË, metodologjia RecyclART udhëzon të rriturit e papunë prej nje kohe të gjatë përmes një PROJEKTI të vetë-drejtuar për të eksploruar aftësitë, kompetencat dhe vlerat e tyre që përndryshe do t'i konsideronin si "MBETJE" - dhe si rezultat, të gjenin një shteg TË RI-KARRIERË

# Përmbajtja

## Pjesa 1: Riciklimi si Rishpikje e Vetvetes

Kapitulli 1: Eksplorimi ..... faqe 03

Kapitulli 2: Përshtatja..... faqe 08

Kapitulli 3: Njohja..... faqe 09

Kapitulli 4: Ekspedita..... faqe 12

Kapitulli 5: Komunikimi ..... faqe 15

## Pjesa 2: Aktivitete Projektuese Kreative Riciklimi

Aktiviteti 1: Cohat..... faqe 22

Aktiviteti 2: Qelqi..... faqe 27

Aktiviteti 3: Metali..... faqe 31

Aktiviteti 4: Vajrat..... faqe 36

Aktiviteti 5: Plastika..... faqe 40

# KAPITULLI 1 | Orientimi dhe Eksplorimi

## Cfarë është orientimi në karrierë?

Të pasurit karriere do të thotë më shumë sesa thjesht “gjetja e një pune”. Dhe të kesh një pune jo domosdoshmerisht nënkupton të pasurit e një karriere. Kjo është veçanërisht e rëndësishme t’u komunikohet njerëzve të cilët janë të papunë për një periudhë të gjatë kohe. Këtu ka një paralelizëm interesant me riciklimin!

Arti i riciklimit po shkon përtej qëllimit fillestar të një produkti dhe po sjell më shumë nga sa ishte konceptuar fillimisht.

Në mënyrë të ngjashme, arti i vetë-rishpikjes po shkon përtej qëllimit fillestar për të gjetur një punë duke rishqyrtuar dhe nxjerrë më shumë në pah përvojat, aftësitë, njohuritë dhe kompetencat që secili prej nesh zotëron.

Natyralisht, çdo proces i “rishpikjes” mundet të drejtojë potencialisht drejt “riorientimit”. Si rrjedhim ne mund të gjejmë përmbushje profesionale në një fushë që nuk e kishim parashikuar fillimisht.

Me këtë në mendje dhe në përputhje me kohën që keni për trajnimin, këtu janë disa sugjerime se si mund të filloni trajnimin.

## Si të mësoni rreth orientimeve të karrierës

### Prezantoni Qellimet

Prezantoni aspektet e vetë-rishpikjes profesionale që keni ndërmend të mbuloni. Paraqitni atë që nxënësit do të mësojnë, fitojnë dhe bëjnë si pjesë e trajnimit.

Meqenëse trajnimi ka të bëjë me "riciklimin" dhe "rishpikjen profesionale", qëllimet e mëposhtme janë të gjitha pika të vlefshme për të udhëhequr trajnimin:

- Kuptoni se si duket planifikimi i duhur i karrierës
- Percaktoni dhe vlerësoni përvojat tuaja të punës dhe jetës së deritanishme
- Njihni vlerat dhe interesat që ju udhëheqin
- Identifikoni opsionet e mundshme dhe të rëndësishme të karrierës për veten tuaj

## Vendosni një gjuhë të përbashkët dhe pritshmëri

Ka dy gjëra të tjera që duhen marrë në konsideratë kur filloni një trajnim.

Së pari, sigurohuni që përmbajtja të jetë e ngjashme (e pershtatshme), në mënyrë që nxënësit të mund ta identifikojnë veten në atë që do të prezantohet. Kjo do të thotë që shembujt që përdorni për të krijuar terrenin për trajnimin dhe më vonë për t'i përdorur për të shtjelluar pika të ndryshme duhet të jenë të tillë që nxënësit të mund ta identifikojnë veten në shembuj.

Së dyti, sigurohuni që të gjithë janë në të njëjtën linjë dhe flasin të njëjtën gjuhë, d.m.th., të kenë një kuptim të ndërsjellë të kuptimit me të cilin përdorni fjalët kyçe. Sa herë që prezantoni një term ose një koncept, është e rëndësishme të merrni pak kohë dhe të shpjegoni kuptimin me të cilin do ta përdorni. Duke vepruar kështu, do të shmangni konfuzionin e panevojshëm dhe do të reduktoni në masë të madhe keqinterpretimin e materialit tuaj.

### Shembull për të filluar: “Çfarë është një karrierë?”

Pas prezantimit fillestar, pyesni pjesëmarrësit "Çfarë është një karrierë?" Ju gjithashtu mund t'i shkruani përgjigjet e tyre. Ajo që është e rëndësishme është që po krijoni atë bazë të përbashkët që diskutuam. Pasi ta bëni këtë, mund të futni pika shtesë, të papërmendura.

Merrni parasysh idetë e mëposhtme:

- Punë me pagesë dhe punë vullnetare
- Puna në një zyrë dhe drejtimi i një biznesi të vogël nga shtëpia - Të punosh në të njëjtën industri gjatë gjithë jetës dhe të punosh në industri të ndryshme
- Të punosh në të njëjtin sektor gjithë jetën dhe të punosh në sektorë të ndryshëm

Rezultati kryesor për tu arritur është ky - karriera nuk është aq lineare dhe e ngurtë sa dikur. Dhe mënyra se si keni arritur në atë pikë është përmes një ndërveprimi që ka përfitimet e mëposhtme.

Së pari, ju morët kuptimet që pjesëmarrësit kanë për karrierën - kjo ju lejon të shikoni në mendjet e tyre, në mënyrë që të dini më mirë se si mendojnë ata dhe si të komunikoni me ta;

Së dyti, kjo i bën nxënësit më të hapur dhe më të investuar në lidhje me atë që do të ndani më pas, sepse ju u dhatë atyre mundësinë të flasin dhe të ndjehen të dëgjuar.

Së treti, ju merrni mirekuptimin e vendosur dhe e zgjeroni më tej atë në një mënyrë më të plotë dhe më të kuptueshme.

## Prezantimi i një strukture për "projektin tonë krijues"

Ashtu si riciklimi i produktit, vetë-rishpikja përfaqëson një përpjekje krijuese. Sidoqoftë, "kreativ" nuk do të thotë "i paorganizuar". Kjo është arsyeja pse, pasi të keni krijuar disa gjuhë të përbashkëta dhe qëllime që pritet të arrihen, është e rëndësishme të propozoni një kornizë orientimi në karrierë.

Një kornizë është e vlefshme sepse e kthen një përpjekje në një proces hap pas hapi. Në rastin tonë, ne kemi dy procese hap pas hapi të cilat i quajmë projektet tona krijuese.

Është mjaft interesante që të dy projektet tona krijuese mund të ndahen në 5 hapa themelorë.

Nga njëra anë, ne kemi projektin tonë të riciklimit të produkteve ku:

- Eksplorojmë mjedisin tone
- Identifikojmë mundësitë për riciklim
- Përcaktojmë gjithçka që na nevojitet
- Prodhojmë produktin tonë të ricikluar
- E ndajmë me botën ose e paraqesim për publikun

Nga ana tjetër, ne kemi projektin tonë të vetë-rishpikjes ku:

- Vetë-eksplorojmë
- Identifikojmë mundësitë
- Përcaktojmë se çfarë duhet të bëjmë
- Zbatojmë vendimet tona
- Ndajmë dhuntitë tona me botën

Arsyeja pse këto të pesta janë "hapa", është se ka një sekuençë në performancën e tyre. Përveç kësaj, kur dikush duhet të mësojë qëllimisht orientimin në karrierë ose të studiojë rrugën e tij të karrierës, pika e fillimit është gjithmonë "Vetëeksplorimi"

Dikush mund të mendojë se "Identifikimi i mundësive" mund të jetë pika fillestare në vend që, dhe ndërsa kjo sigurisht mund të jetë rasti, te neglizhuarit e fazës së "Vetë-eksplorimit" vetëm do të komprometojë ndonjë nga rezultatet që do të merren në fazat e mëvonshme.

Kjo nuk do të thotë se procesi nuk mund të ndahet në më pak ose më shumë, hapa më të vegjël, më të mëdhenj. Sasia e detajeve dhe koha që i kushtoni secilit hap do të varet nga sasia e kohës që keni për stërvitje në radhë të parë. Për shembull, në indeksin e manualit, mund të shihni një nomenklaturë të ndryshme të përdorur për të përshkruar procesin:

“Eksplorim-Përshtatje-Njohje-Ekspeditë-Komunikim”

Thelbi gjithsesi mbetet i njëjtë.

REzultati kryesor për tu arritur është ky - ju dëshironi te dilni në konkluzionin që orientimi në karrierë duhet më mirë të fillojë me "Vetë-eksplorimin". Kjo është thelbësore pasi vetë-eksplorimi është thelbi i rikuperimit të vetëvlerësimit të nxënësve, si dhe i udhëheqjes së tyre drejt një rruge karriere që ata janë të gatshëm, të aftë dhe të interesuar ta ndjekin.

## Ushtrimet dhe aktivitetet e marra në konsideratë

Pasi t'i keni prezantuar nxënësit me kornizën, është e rëndësishme të merren parasysh ushtrimet dhe aktivitetet që lidhen me termat dhe kategoritë e mëposhtme.

### Veprimet fillestare

Si me çdo hap dhe aktivitet të mëtejshëm është e rëndësishme të vazhdohet të bëhen paralelizmat e nevojshme që mbart vete-rishpikja dhe te riciklimi. Meqenëse kjo është ose dita e parë ose pjesa e parë e trajnimit tuaj, motivi themelor është nevoja dhe zhvillimi i një plani.

Siç e kemi përcaktuar tashmë, riciklimi, ashtu si vetë-rishpikja, është një projekt

krijues. Dhe ashtu si të gjitha projektet e tjera, edhe ato kreative kërkojnë që të keni një plan.

Vendi më i mirë për të filluar është të kryeni një vetë-auditim. Ky është themeli që do të diktojë si zgjedhjet krijuese në lidhje me riciklimin, ashtu edhe vendimet që dikush merr në lidhje me karrierën e tij.

Ajo gjithashtu ka përfitimin e udhëzimit të nxënësve drejt ndërtimit të vetëvlerësimit të tyre në një mënyrë të shëndetshme - kjo është për shkak se ju po i udhëzoni ata të shikojnë veten për të ndërtuar atë vetë-imazh më të mirë, në vend që të shikojnë stimujt dhe zgjidhjet e jashtme.

## Tërheqja dhe kenaqësia e punës

Ftojini nxënësit të eksplorojnë atë që u pëlqen më shumë nga puna. Duke vepruar kështu, bëhet më e lehtë të kuptosh si llojet e punës që do t'i përshtaten më mirë një nxënësi, ashtu edhe ato që duhen evituar. Kjo do të shërbejë si një bazë për të ditur më mirë se cilat aftësi duhet të zhvillohen dhe cilat mundësi ia vlen të shpenzoni kohë duke u përgatitur për më vonë.

## Vlerat e punës dhe kënaqësia në punë

Një ushtrim si ky përdoret më së miri si vazhdim i të mëparshmit. Kjo ju lejon të kuptoni edhe më mirë se çfarë do të thotë për veten të kesh "një punë të kënaqshme". Përdorni një listë faktorësh që nënkuptojnë diçka për personalitetin e dikujt dhe llojin e punës që dikush mund ta njohë si të vlefshme dhe të kënaqshme. Më pas, mund të renditni më tej faktorë të ndryshëm sipas rëndësisë. Kjo do t'i ndihmojë pjesëmarrësit që jo vetëm të kuptojnë atë që vlerësojnë, por gjithashtu të fillojnë të reduktojnë faktorët dhe idetë që mund të kenë si dytësore dhe të panevojshme.

## Besimet dhe vlerat personale

Të paturit e një aktiviteti që lidhet me vlerat dhe besimet e dikujt mund ta ndihmojë nxënësin të mendojë me kujdes se si këto mund të ndikojnë në opsionet e punës që ata tërhiqen.

Sa më të qartë të jemi se përse po i bëjmë gjërat, aq më e lehtë është të jetojmë



me zgjedhjet dhe kompromiset që po bëjmë.

Është e rëndësishme të theksohet këtu se besimet dhe vlerat, megjithëse personale, nuk duhet të kufizohen në mirëqenien e individit. Kjo do të thotë se dëshirat tona për kontribut në mirëqenien kolektive-sociale janë po aq të rëndësishme në një vetë-auditim sa ç'janë edhe vlerat dhe besimet që lidhen me mirëqenien e vetë personit.

Gjithashtu, sigurohuni që t'u kujtoni nxënësve se nuk ka përgjigje të sakta ose të gabuara dhe gjithmonë mund t'u ktheheni aktiviteteve dhe të përditësoni të menduarit tuaj, ndërsa përparoni gjatë trajnimit.

## Interesat e terheqjet

Ajo që vlerësoni në jetë lidhet natyrshëm me atë që ju intereson më shumë. Një aktivitet i fokusuar në eksplorimin për atë që nxënësit janë me të vërtetë të interesuar dhe të magjepsur mund t'i ndihmojë ata që më pas të mendojnë se si mund t'i sjellin ato gjëra në punën e tyre.

Një shënim për zgjedhjen e fjalës këtu. Mund të vini re se nuk po flasim për "pasionë". Kjo është e qëllimshme, pasi pasioni shpesh shoqërohet me një numër shumë më të ngushtë aktiviteteve dhe është diçka që njerëzit e konceptojnë që dikush është i motivuar për të bërë dhe lulëzon duke e bërë pa përpjekje. Nga ana tjetër, interesat dhe terheqjet ju lejojnë të keni një dialog më konstruktiv dhe të konceptoni gjërat për të cilat jeni të interesuar dhe të terhequr si diçka që ju duhet të ndërtoni dhe zhvillonin.

Ju mund të merrni një moment shtesë për të shpjeguar zgjedhjen tuaj të fjalëve nëse e gjeni të përshtatshme dhe koha juaj e trajnimit e lejon këtë.

## KAPITULLI 2 | Përshtatja

Të paturit te qartë se cilat janë kufizimet(limitet) dhe përgjegjësitë tuaja mund t'ju ndihmojë të merrni një vendim të bazuar nse si t'i qaseni eksplorimit të karrierës suaj.

Secili prej nesh ka një sërë faktorësh personalë që mund të ndikojnë në zgjedhjet tona të karrierës. Këto mund të përfshijnë:

- Fitimi i një shumë të caktuar parash
- Mirëqenia juaj
- Mosha
- Të qenit kujdestari kryesor për një anëtar të familjes
- Dëshira për të jetuar në një vend të caktuar
- Kërkoni të merrni një kualifikim të shpejtë ose një që nuk është aktualisht i disponueshëm
- Të qenit i njohur profesionalisht në një sektor të caktuar të punës

Nxënësit mund të mos ndihen aq energjik për të marrë parasysh pengesat e mundshme sa ndihen kur eksplorojnë interesat e tyre. Megjithatë, ata kanë nevojë për një vlerësim të balancuar të situatës së tyre. Sjellja e kësaj përpara një aktiviteti në lidhje me këtë çështje do të shpërndajë disa nga shqetësimet e parashikuara.

Pasi ta bëni këtë, merrni parasysh një aktivitet si më poshtë.

## Eksplorimi i aftësive tuaja

Ky aktivitet i ndihmon nxënësit të vlerësojnë se çfarë kanë nevojë, çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë nuk mund të bëjnë lehtësisht në jetën e tyre në këtë moment. Në fund, do t'i inkurajojë ata të mendojnë për implikimet e secilit kufizim dhe të shohin rrugët që kanë përpara.

Paraqiten katër kategoritë e mëposhtme:

- Nevojat
- Përgjegjësitë
- Kufizimet
- Avantazhet

Duke ndjekur faktorët që ndikojnë në karrierë që diskutuam, çdo nxënës mund të shkruajë gjëra që lidhen me ato kategori dhe që ai i dallon si pengesa në situatën e tij.

Më pas, çdo nxënës duhet të artikulojë implikimet që çdo faktor kufizues ka për

situatën e tyre. Mbani shenim se "Implikimet" janë sygjerim me i mire se "Problemët". Inkuadrimi i faktoreve si implikime në të vërtetë bën faktorin të duket me shume se vec të "nënkuptuarit" e cilesisë së tij të një sprove. Për këtë arsye le hapësirën e nevojshme për të menduar më pas për faktorin si diçka që mund të zgjidhet.

Plus, duke artikuluar se cili është "problemi" i saktë që krijon një faktor i caktuar do të ishte më e lehtë të hartohet një zgjidhje specifike me pas.

Pasi ta bëni këtë, hapi i fundit është të mendoni "Çfarë mund të bëj për këtë".

Keshtu, në tre hapa të (1) deklarimit të kufizimit, (2) njohjes së implikimeve të tij dhe (3) krijimit të një zgjidhjeje, ju jeni në gjendje të mbledhni të gjithë informacionin e nevojshëm për të eksploruar dhe eksperimentuar më pas me ato mundësi karriere që janë më të përshtatshme.

## Kapitulli 3 | Njohja

Per te thyer hendekun midis gjendjes aktuale të të qenurit dhe dëshires për karriere ju duhet të udhëzoni nxënësit për të kuptuar mjetet që ata tashmë kanë në dispozicion.

Kjo është e rëndësishme pasi e lejon nxënësin të kultivojë cilesinë e vetë-vlerësimit që është e bazuar fort në njohuritë, aftesitë dhe kompetencat e tyre. Kjo është gjithashtu e vlefshme nga perspektiva e progresit. Me fjale të tjera të kuptuarit më mirë të asaj që ju jeni të aftë të bëni ju tregon gjithashtu gjërat që ju duhet të zhvilloni më tej në mënyrë që të merrni mundësitë profesionale që ju interesojnë.

### Self-Esteem Vete Vleresimi

Gjeja e parë që duhet konsideruar është që të merrni pak kohë për të shpjeguar çfarë nënkuptoni me "vete-vleresim". Një analizë e konceptit të "vetëvlerësimit" nga 2017 sugjeron atributet e mëposhtme si të lidhura me vetëvlerësimin:

- Vete-Vleresim
- Vete-Pranimi
- Vete-Efikasiteti

- Vete-Respekti
- Qëndrimi ndaj vetes

Tashme kur thoni se eksplorimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave të dikujt ka një efekt pozitiv në vetë-vlerësim, është më e qartë saktësisht se çfarë do të thoni dhe gjithashtu tregon gamën e efekteve pozitive që ka.

Sigurisht, është gjithashtu e rëndësishme të merrni një moment dhe të mendoni për një kornizë që ju lejon të bëni një dallim midis njohurive, aftësive dhe kompetencave. Arsyeja pse ne kemi filluar të flasim për këto 3 koncepte nga shumë heret është se nuk ka një përkufizim të pranuar përgjithësisht se çfarë do të thotë secili prej tyre. Prandaj, si instruktor, duhet të bëni dy gjëra të rëndësishme.

1. Komunikoni me audiencën se ka një paqartësi teorike rreth termave njohuri, aftësi dhe kompetenca.
2. Për shkak të kësaj, ju duhet të merrni një moment për të artikuluar dhe komunikuar kuptimin me të cilin do të përdorni të treja.

Thënë kështu, më tej është një kornizë shembulli që mund të përdorni.

**Njohuria** mund t'i referohet rezultatit të asimilimit të suksesshëm të informacionit përmes të mësuarit. Njohuria është tërësia e fakteve, parimeve, teorive dhe praktikave që lidhen me një fushë pune ose studimi.

**Aftësitë** mund t'i referohen njohurive praktike. Ju mund të hasni aftësi të përdorura si zëvendësim për "aftësitë e vështira", d.m.th. të krijoni produkte të prekshme. Nëse vendosni të përdorni "aftësitë" në këtë mënyrë, atëherë një shembull do të ishte: aftësia për të ndërtuar një faqe interneti, për të luajtur një instrument, për të hartuar një plan arkitekturor, për të rregulluar një makinë ose për të krijuar një tabelë Excel.

**Kompetencat** nga ana tjetër mund të përdoren si sinonim për aftësitë e buta. Ato gjithashtu mund të quhen aftësi të transferueshme. Nëse vendosni të përdorni "kompetencat" në këtë mënyrë, atëherë shembuj do të ishin gjëra të tilla si priorizimi i detyrave, të menduarit kritik, menaxhimi i kohës, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, menaxhimi i stresit.

Ky aktivitet krijues do t'ju ndihmojë të identifikoni rolet që keni luajtur në jetën tuaj deri tani dhe kështu t'ju ofrojë një bazë për të marrë parasysh aftësitë që ju

kanë ndihmuar të zhvillojnë.

## Ushtrime dhe aktiviteteve për tu shqyrtuar

Përpara se të hyni në ushtrime dhe aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nxënësve, mund të jetë e vlefshme të merren parasysh rolet që pjesëmarrësit kanë luajtur në jetën e tyre deri në këtë pikë. Arsyeet pse perdorim “Rolet” dhe jo “Punët” është sepse e mëparshmjia përfshin një spektër shumë më të gjerë përvojash të cilat të gjitha mund t’i kenë lejuar pjesëmarrësve të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që ata i, kanë por ndoshta nuk i kanë marrë parasysh nëse kanë qenë të fokusuar vetëm në përpjekjet e tyre profesionale.

### Rolet ndaj attributeve

Perveç se të paturit një rol si punonjës secili prej nesh mund të përmbushë edhe një sërë rolesh të tjera. Ju mund të keni një rol si prind, si mik, si student, si mësues - lista vazhdon.

Për shembull, nëse keni qenë më parë student, do t’ju nevojiteshin aftësitë e të mësuarit, menaxhimit të kohës dhe komunikimit me shkrim.

Ndoshta ju pëlqejnë projektet "bëje vetë" (DIY)? Nëse po, ju keni zhvilluar jo vetëm aftësi praktike, por edhe aftësi planifikimi dhe organizimi.

Nëse jeni prind, keni zhvilluar aftësi për kujdesin ndaj fëmijëve, por ndoshta edhe ato të buxhetimit, menaxhimit të kohës, delegimit, gatimit etj.

Duke kryesuar mbledhjet e një klubi, ju zhvilloni aftësitë e komunikimit me njerëzit, si dhe ato të menaxhimit të diskutimit.

Pasi të keni kaluar nëpër një ushtrim që i lejon pjesëmarrësit të shikojnë më gjerësisht dhe teresisht në përvojat e tyre, tani mund konsideroni ushtrime shtesë që hetojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e tyre veçmas.

## Kapitulli 4 | Eksplorimi

Tani që nxënësit kanë një listë më të saktë të karrierave të mundshme, ata janë gati të eksplorojnë mundësitë. Këtu paraqiten disa mënyra se si mund të shikoni së pari se çfarë përfshin një rol pune.

## Intervistat informuese

Konsideroni të kontaktoni një profesionist në fushën tuaj të dëshiruar për t'u ulur me ju e për t'iu përgjigjur pyetjeve. Ju mund të zbuloni edukimin, trajnimin, rolet e nivelit fillestar dhe aspekte të tjera që ata ndoqën përgjatë rrugës së tyre të karrierës. Një intervistë informuese gjithashtu mund t'ju ndihmojë të ndërtoni rrjetin tuaj profesional brenda industrisë suaj të synuar, gjë që mund të ndihmojë procesin tuaj të kërkimit të punës në të ardhmen. Intervistat informuese e janë të shkëlqyera jo vetëm sepse mund të merrni shumë njohuri të vlefshme për industrinë dhe punën për të cilën jeni të interesuar, por gjithashtu mund të shërbejë si trampolinë në të gjitha mundësitë e tjera që ne do të mbulojmë.

## Vrojtimi i Punës

Ky aktivitet përfshin një ditë, një javë ose një periudhë tjetër të shkurtër duke vëzhguar një profesionist në punë. Mund t'i shoqëroni në takime ose t'i shikoni duke demonstruar se si e kryejnë punën e tyre tipike të përditshme. Ju gjithashtu mund t'u bëni pyetje gjatë kohës që jeni me ta për të kuptuar më mirë rrugën dhe përvojën e tyre të karrierës.

## Vullnetarizmi

Puna vullnetare është punë pa pagesë, zakonisht e kryer në kohën e lirë.

Some organizations may alloë you to volunteer for tasks that your ideal role ëould handle to gain more hands-on experience. Disa organizata mund t'ju lejojnë të bëni punë vullnetare për detyra që do të mund të realizonit në rolin juaj ideal, për të fituar më shumë përvojë praktike Kjo gjithashtu mund t'ju ndihmojë të përcaktoni nëse mund të kënaqeni duke punuar në atë rol, industri ose lloj vendi pune.

Mos harroni se puna vullnetare kërkon angazhim, ashtu si një punë me pagesë. Prandaj, duhet të jeni realist se sa kontribut mund të ofroni krahas punës tuaj ekzistuese dhe angazhimeve personale. Mund të ndodhë që ngjarja e rastësishme "një herë" ose një projekt afatshkurtër t'i përshtatet më së miri kohës që keni në dispozicion. Përndryshe, mund të gjeni një angazhim të rregullt, më afatgjatë, por të përmbajtur, si një orë në javë, më i lehtë për t'u mbajtur.

## Përdorni pyetjet e mëposhtme për të nxitur mendimin tuaj për punën vullnetare.

- Pse mund të jeni të interesuar për vullnetarizëm?
- Cilat kauza do t'i shihnit si të vlefshme?
- A keni ndonjë aftësi ose ekspertizë të specializuar, jeni të gatshëm ta ndani me të tjerë?
- A ka ndonjë cilësi të veçantë personale që mendoni se ju përshtatet për të punuar si vullnetar, siç është aftësia për t'i bërë të tjerët të ndihen rehat, ose për t'i patur empati për ta dhe situatën e tyre? Apo jeni të mirë në zgjidhjen praktike të problemeve?
- Dëshironi të punoni me një grup të caktuar klientësh si pleq, fëmijë ose të rritur me vështirësi në të mësuar? Ose në një fushë të caktuar si mjedisi, të pastrehët ose shkrim-leximi për të rriturit?
- Sa kohë mund të ofroni realisht dhe a po kërkon një angazhim afatshkurtër apo afatgjatë?
- Çfarë pune vullnetare mund t'ju përshtatet?
- A do t'ju duhet të mbuloni shpenzimet tuaja bazë në mënyrë që të përfshiheni si vullnetar?
- Sa larg jeni të përgatitur për të udhëtuar për të ndërmarrë punën?
- Çfarë lloj përmbyshjeje dëshironi të fitoni nga puna vullnetare?
- Çfarë mendoni se mund t'ju duket më sfiduese në lidhje me punën vullnetare?

## Praktikat

Konsideroni një praktikë për përvojë më të drejtpërdrejtë në terren. Këto mundësi ka të ngjarë të japin detyra më të rëndësishme për rolin tuaj të synuar.

## Punë me kohë të pjeshme

Versionet me kohë të pjesshme të shumë punëve mund të jenë të disponueshme me më pak kërkesa të nivelit fillestar. Mund t'i gjeni në kompani specifike për të cilat mund të konsideroni të punoni dhe në role të tipit asistent që ndërveprojnë drejtpërdrejt me rolin tuaj të synuar.

## Gjeni një mentor në industri

Të shikosh një mentor me përvojë dhe ta dëgjosh duke folur për realitetet e një karriere mund të jetë shumë informuese. Ju mund të konsideroni aplikimin e zgjedhjeve të rrugës së tyre të karrierës në planifikimin tuaj për të identifikuar hapat që mund të funksionojnë gjithashtu për ju.

## Kurse

Nëse ndiqni ndonjë formë të arsimit të lartë, merrni parasysh zgjedhjen e kurseve që lidhen me zgjedhjet e mundshme të karrierës. Këto klasa mund t'ju ofrojnë informacion dhe trajnim themelor përmes projekteve dhe eseve, të cilat mund t'ju ndihmojnë të kuptoni disa nga bazat e një karriere.

## Si të qasemi drejt njerëzve të tjerë duke krijuar një rrjet

Një gjë e rëndësishme për t'u marrë parasysh është se çdo zgjidhje përfaqëson gjithashtu një mundësi për të krijuar një rrjet dhe për të takuar njerëz që mund të bëjnë diçka të ngjashme me atë që nxënësit janë të interesuar. Për shkak të kësaj, është e rëndësishme të merret në konsideratë mënyra se si ata po arrijnë të kontaktojnë me njerëzit dhe institucionet. Këtu janë disa pyetje të rëndësishme për t'u marrë parasysh për zhvillimin e ushtrimeve dhe aktiviteteve stërvitore përreth:

- A duhet t'u dërgoj email, të telefonoj ose të flas ballë për ballë?
- Çfarë t'u them atyre se pse i jam afruar?

Çfarë pyetjesh duhet të bëj, për atë që ata kanë për të ofruar?

Keni synime të qarta – vendosni qëllime që mund t'i arrini në mënyrë të arsyeshme në atë periudhë.



- Kuptoni nevojat tuaja – ato duhet të përshtaten me organizatën që ju ofron përvojë pune.
- Gjeni mbështetje – kërkoni një person të emërtuar i cili është përgjegjës për të ndihmuar në arritjen e suksesit të përvojës suaj të punës.
- Merrni komente - pyesni nëse keni treguar një aftësi për punën ose keni demonstruar të mësuarit e aftësive të nevojshme.
- Ndërttoni kontaktet tuaja - kërkoni mundësi për të krijuar kontakte, të kujtoni bisedat gjatë pushimeve të kafesë ose drekës mund të jetë perfekte për këtë.
- Rishikoni atë që keni bërë – çfarë mësova për punën, punëdhënësin apo veten time nga kjo përvojë?

## KAPITULLI 5 | Komunikimi

Pasi të keni përfunduar produktin tuaj të ri të ricikluar, është e rëndësishme të ndani dhuratën (dhuntinë) tuaj me botën. E njëjta gjë është e vërtetë me gjetjen e një vendi për të realizuar veten profesionalisht.

Ndërsa nxënësit fillojnë të eksplorojnë dhe gjejnë mundësi karriere, është e rëndësishme që ata të dinë se si t'ua komunikojnë të tjerëve të gjitha gjërat që dinë për veten e tyre. Këtu i gjithë informacioni që ata kanë mbledhur dhe dinë për veten e tyre kulmon më tej në përmbajtje që mund të ndahet.

Ka dy lloje pyetjesh që janë pothuajse të garantuara se do t'ju bëhen në një intervistë pune/intershipi, gjithashtu kur jeni duke krijuar rrjetin e njohjeve, takimi me njerez te rinj ose edhe kur krijoni përmbajtje ne internet.

E para është “Më trego për veten tënde”

E dyta me siguri do të jetë një variant i një pyetjeje të sjelljes, si p.sh.: "Më

trego për një kohë kur bërë X-Y-Z".

Pyetje si këto mund të duken si një "shkëmbim i vogël bisede", por dobia e tyre shkon përtej kësaj. Ne përdorim pyetje si këto për të kuptuar më mirë se çfarë personi qëndron para nesh, si dhe për të fituar një pasqyrë në lidhje me vetë-perceptimin e

tyre - të gjitha gjërat që janë të rëndësishme për ...

Për shkak të kësaj, është e rëndësishme që:

- të mendoni duke reflektuar për përvojat tuaja;
- të artikulonit jo vetëm atë që keni bërë, por edhe si e keni bërë atë;
- të komunikoni ndikimin që përvojat tuaja të mëparshme kanë pasur në të menduarit dhe qëndrimin tuaj ndaj punës.

Le të flasim duke artikuluar përgjigjet e duhura për 2 pyetjet kryesore të permendura.

## “Më trego për veten tënde”

Konsideroni një përgjigje që ofron disa informacione të rëndësishme në sfond për interesat dhe terheqjet tuaja. Pastaj, sigurohuni që përgjigja juaj të jetë e lidhur me përpjekjet tuaja aktuale profesionale, p.sh., një fushë në të cilën po studioni, dëshironi të punoni ose aktualisht po fitoni përvojë.

Në një situatë rrjeti njohjesh, ju dëshironi të keni një përgjigje më të përgjithshme, e cila ju shërben ju si "karte biznesi" dhe i fton njerëzit të jenë kureshtarë dhe të bisedojnë me ju për gjërat që ju interesojnë.

Në një intervistë pune/stazhi, ju dëshironi që përgjigja juaj të jetë pak më e përshtatur në përputhje me mundësinë për të cilën jeni duke intervistuar. Informacioni që dëshironi të ndani për veten tuaj duhet të përfaqësojë interesat dhe përvojat që keni që janë të rëndësishme për pozicionin për të cilin po intervistoni.

Sido që të jetë, mënyra më e mirë për të menduar për përgjigjen tuaj është një histori 2-minutëshe se në çfarë jeni të mirë dhe/ose pse jeni i përshtatshëm për një pozicion të caktuar.

## Si të krijoni përgjigjen tuaj

Përdorni pyetjet e mëposhtme si udhëzues për të krijuar një përgjigje solide "më trego për veten".

1. Si u interesuat për industrinë e caktuar?
2. Cilat përvoja (klasa, praktika/punë, libra, njohje, biseda, etj.) zgjuan interesin tuaj në fushën e caktuar?

3. Çfarë keni bërë në këtë fushë për të eksploruar/ndjekur interesin tuaj apo që ka konfirmuar interesin tuaj?
4. Per çfare jeni te interesuar tani (ne nje situatë rrjeti njohjesh)
5. Pse jeni të interesuar për këtë pozicion tani (në një situatë interviste)

Përgjigjja e secilës prej këtyre pyetjeve me 2 deri në 5 fjali do të gjenerojë përmbajtje të mjaftueshme që ju të krijoni historinë tuaj.

Pasi t'i përgjigjeni të gjitha pyetjeve, sigurohuni t'i bashkoni ato si një paragraf. Sigurohuni që ti redaktoni te gjitha së bashku, kështu që kur ta lexoni si një, të tingëllojë koherente.

Së fundi, në mënyrë që të mësoni përmendësh historinë tuaj dhe ta zotëroni atë, praktikoni ta tregoni me zë të lartë. Duke vepruar kështu, do të ndiheni shumë më të sigurt dhe të rahatshëm duke e ndarë atë me të tjerët.

## “Pyetje të sjelljes”

Pyetjet e sjelljes zakonisht fillojnë me "Më trego për një kohë kur" ose "Më jep një shembull të një kohe/përvoje kur ...”

Dallimi midis një pyetjeje të sjelljes dhe pyetjes "më trego për veten" është se pyetjet e sjelljes janë më specifike. Dhe kushdo që pyet është në kërkim të një shembulli konkret që tregon aftësitë dhe cilësitë tuaja specifike.

Ngjashëm me çdo pyetje tjetër që përgjigjeni, ju dëshironi ta mendoni përgjigjen tuaj si një histori. Në këtë rast, për shkak se historia juaj supozohet të jetë në lidhje me një shembull specifik, atëherë është një ide e mirë që të keni gjithashtu një strukturë specifike që ofron kontekst të mjaftueshëm, detaje përkatëse, rezultate dhe atë që keni mësuar nga përvoja.

Një mënyrë për të strukturuar historinë tuaj është duke ndjekur modelin "S.V. R.A", i cili është një akronim kujtëse për 4 hapat e mëposhtëm: Situata, Veprimi, Rezultati, Aplikimi.

**Situata** Ky është konfigurimi për historinë tuaj.

Artikloni një përgjigje për:

“Cila ishte situata?”

“Cili ishte problemi apo mundësia me të cilën po përballeshit?”

**Veprimi** kjo është zgjidhja që keni vendosur të aplikoni.

Artikloni një përgjigje për:

“Çfarë veprimi keni marrë?”

**Rezultati** kjo është ajo çfare ndodhi si pasojë e përpjekjeve tuaja.

Artikloni një përgjigje për:

“Cili ishte rezultati bazuar në veprimin që keni bërë?”

(Sigurohuni që të jepni detaje specifike dhe të përcaktoni sasinë e rezultateve tuaja kur është e mundur).

**Aplikimi**, çfarë keni arritur si rezultat i kësaj situatë

Artikloni një përgjigje për:

Çfarë mësimesh mësuat?

Çfarë aftësish keni fituar?

Çfarë cilësish keni zhvilluar me këtë përvojë?

Si do t'ju ndihmojnë ata të kontribuoni në ekipin e punëdhënësit të ardhshëm në pozicionin për të cilin jeni duke intervistuar?

## Përshkrimi i përvojave tuaja

Në të njëjtën mënyrë që bashkoni histori për t'i ndarë kur takoheni me njerëz, ju mund t'i ndani historitë pas përvojave tuaja në prezantimet tuaja të shkruara (CVs, Resyme,

Letra motivuese)

## Përdorni Pika orientuese

Përdorimi I Pikave (paragrafeve) janë deklarata veprimi që shfaqin atë që keni kontribuar në rolet e mëparshme, në mënyrë që punëdhënësi të mund të shohë aftësitë që ju i sillni atij. Nën çdo përvojë në CV-në tuaj, do t'i përfshini këto përshkrime në formën e pikave.

## Si të krijoni pika të forta orientuese (referuese)?

Filloni me një folje veprimi që ilustron një aftësi të transferueshme.

- Për këtë, nxënësit mund të përdorin atë që kanë krijuar më parë si aftësi që kanë.
  - Pastaj, ata mund të krahasojnë aftësitë e tyre me ato që punëdhënësi po kërkon dhe të shohin se cilat aftësi përputhen.
  - Një gjë për të mbajtur parasysh dhe për të parë është semantika. Do të thotë që punëmarrësi dhe punëdhënësi mund të flasin për të njëjtat gjëra/gjëra të ngjashme, por duke përdorur fjalë të ndryshme. Kur aplikoni për një punë, nxënësi (punë-kërkuesi) duhet t'i kushtojë vëmendje kësaj dhe të identifikojë aftësi të tilla dhe t'i përshtatë fjalët që përdorin për të përshkruar përvojat e tyre me gjuhën e punonjësit. Duke vepruar kështu, ju krijoni një bazë të përbashkët dhe siguroni që të gjithë flasin të njëjtën gjuhë.
  - Ndani informacione specifike për atë që keni bërë, si e keni bërë atë dhe pse e keni bërë atë. - Shmangni gjuhën e përsëritur.
  - Përcaktoni sasinë, kur është e mundur, për të demonstruar ndikimin.
  - Përfshini mjetet ose pajisjet përkatëse (p.sh., Excel, Python, Adobe Photoshop, spektrometria e masës, SPSS, Ëestlaë, etj.)

## Si të zhvilloni pikat orientuese ?

Ashtu si me çdo rast tjetër që kemi parë më parë, një mënyrë për t'u siguruar që po krijoni një përshkrim të vërtetë me ndikim për secilën nga përvojat tuaja është të ndiqni një strukturë që do t'ju mundësonte ta bëni këtë.

Në këtë rast, ju mund ta bëni këtë duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme për secilën nga përvojat tuaja: Çfarë, Si dhe Pse

## CFARE



Cfare bere?

Cila ishte situata, problemi apo sfida me të cilën po përballeshit? Cilat ishin përgjegjësitë apo synimet tuaja?

## SI

Si e keni bërë saktësisht?

Si i keni përmbushur detyrat tuaja?

A keni përdorur ndonjë mjet, pajisje ose program kompjuterik?

A keni punuar si pjesë e një ekipi apo në mënyrë të pavarur?

## PSE

Pse janë të rëndësishme këto veprime?

Si i dhanë dobi organizatës?

Cili ishte rezultati i veprimeve tuaja?

A mund t'i përcaktoni sasine e rezultateve?

Shënim 1: Në lidhje me pyetjen e fundit, jo çdo pikë në CV-në tuaj duhet të jetë e orientuar drejt rezultateve.

Shënim 2: Nuk duhet t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve të listuara. Ajo që është e rëndësishme të mbani në mendje është se, ashtu si kur jeni duke bërë një bisedë, përgjigjet tuaja në thelb tregojnë një mini-histori të përvojave tuaja.

## Pjesa 2: Aktivitete të Ricikimit të projektuar të

### Prezantimi



Në segmentin vijues, do të mësoni një sërë aktivitete të riciklimi të ndërtuara për ju që t'i prezantoni si pjesë të kurrikulës tuaj.

Ky seksion është krijuar si një udhëzues për të kuptuar më mirë formatin në të cilin përshkruhen aktivitetet.

Çdo aktivitet përbëhet nga një segment prezantues, ku mund të gjeni të gjitha materialet e nevojshme për të pasur ëorkshopin tuaj riciklimit të projektuar; procesi i riciklimit të projektuar, si dhe një seksion të aftësive “të buta” (soft).

Çdo ushtrim ndjek formulën projektuese të riciklimit krijues të Artit të

Riciklimit

NEVOJE → **PROJEKT** → **MBETJE** → **OBJEKT I RI**

Ja se çfarë mund të prisni në secilën prej këtyre 4 fazave.

## NEVOJA

Ky segment përshkruan një sërë nevojash që ushtrimi mund të kënaqë. Dy llojet kryesore të nevojave janë personale (që synojnë nxënësin) dhe mjedisore (që synojnë ruajtjen e natyrës). Ju gjithashtu mund të gjeni nevoja të tjera, si ato sociale, si dhe argumente se kur dhe pse prodhimi i mallrave tuaja të ricikluara mund të jetë një ide më e mirë sesa blerja e një produkti të disponueshëm.

## PROJEKTI

Ashtu si çdo produkt tjetër, prodhimi i mallrave të riciklueshme është një projekt. Si i tillë, nxënësit duhet të prezantohen me një kornizë të nivelit të lartë që përfaqëson hapat kryesorë të një projekti. Këto hapa janë:

- Prezantimi
- Planifikimi
- Realizimi
- Konkluzioni

Në varësi të rezultatit përfundimtar të parashikuar, përmbajtja e këtyre 4 hapave

mund të ndryshojë.

Si trajner, është e rëndësishme të qartësoni marrëdhënien midis një projekti riciklimi dhe një projekti të vetë-rishpikjes. Nuk është rastësi që hapat e të dyja këtyre përpjekjeve janë mjaft të ngjashme. Dallimi i vetëm janë fjalët që përdoren për të përshkruar përndryshe dy procese pothuajse identike.

Gjëja e dytë shumë e rëndësishme është të vini në dukje faktin se kursi juaj nuk është vetëm trajnim, por edhe një projekt ku nxënësit po marrin pjesë. Kjo është veçanërisht e vlefshme sepse mund të prezantohet si një përvojë dhe arritje shtesë në rezymenë e pjesëmarrësve (nëse trajnimi përfshin lëndën)

### **MBETJET**

Ky segment ka për qëllim t'ju ofrojë disa pika shtesë interesi në lidhje me materialin e mbetjeve, si dhe të sintetizojë disa nga pjesët kryesore të informacionit që mund të jenë të vlefshme për ju që të dini rreth tij.

### **OBJEKT I RI**

Ky seksion përmbledh cilësitë e produktit të ri të ricikluar që ju dhe nxënësit keni krijuar. Ju gjithashtu mund t'i konsideroni këto si ide të fjalorit që mund t'i përdorni për të lehtësuar cilësitë e produktit të ri. Duke vepruar kështu, ju vazhdoni t'u kujtoni nxënësve qëllimin e produktit, aktivitetin dhe atë që ata do të "marrin" përfundimisht si rezultat i përpjekjeve të tyre.

### **AFTESITE E BUTA (SOFT)**

Ky seksion paraqet një përzgjedhje të aftësive të buta që nxënësit zhvillojnë si pjesë e përpjekjeve të tyre projektuese për riciklimin. Mendoni për aftësitë e buta të sugjeruara si një rrugë për të demonstruar se si edhe një aktivitet "i thjeshtë" si krijimi i një produkti të ri të ricikluar përfshin një spektër shumë më të gjerë aftësish, të cilat të gjithë pjesëmarrësit po i kultivojnë dhe i demonstrojnë gjatë trajnimit. Të mësuarit dhe mësimdhënia rreth aftësive përkatëse të buta mund t'u japë gjithashtu nxënësve një perspektivë të re për pjesën tjetër të përvojave të tyre dhe të përforcojë paralelet midis riciklimi projektues dhe vetë-rishpikjes. Mos harroni se të gjitha aftësitë e buta të sugjeruara nuk kanë për qëllim të jenë një listë e dobët (e vakët, shteruese), kështu që nëse krijimtaria juaj ju bën të gjeni aftesi të tjera paralele që nuk janë përshkruar, jeni të mirëpritur t'i përdorni ato.



# Aktiviteti i riciklimit 1

**Emri: Xhinse të ricikluara në Çanta**

**Koha: 5 ore**

**Riciklimi: Xhins**

## Mjetet & Materialet

- Xhinse te vjetra,
- Gjilpërat,
- Fill ose fije,
- Gërshërë,
- Vizore/gome,
- Ruler,
- Shkumës,
- Tavolinë për të vendosur pjeset e xhinseve për t'i skicuar e dizenuar,
- Një vend për të punuar (dhomë, ose hapësirë)

## Përshkrimi i Përgjithshëm

Aktiviteti i riciklimit të xhinseve konsiston në prodhimin dhe shitjen e cantave aksesore për blerje, të bëra nga xhinse të ricikluara për të kufizuar dhe zëvendësuar përdorimin e qeseve plastike në supermarkete dhe qendra tregtare. Xhinset e papërdorshme të të gjitha llojeve mund të përdoren si material i ricikluar për cantat për blerje. Qeset plastike mund të zëvendësohen duke ricikluar xhinse dhe krijuar çanta xhins. Xhinsi është një material i fortë,

rezistent, i lehtë për tu shkurtuar dhe personalizuar.

## Aktiviteti

Në çështjen që ne po trajtojmë siç edhe është përmendur më sipër, palët e xhinseve që kanë mbetur në stok nga fushatat e tjera krijuar me suport financiar prej dhuruesve të tjerë (të kaluar) ( fushata të tilla janë bërë në universitete të ndryshme të Shqipërisë) janë përdorur për të prodhuar çantat e blerjeve.

Procedura fillon me pastrimin e lëndës së parë (xhinset) duke i dërguar në pikën e pastrimit kimik. Pas marrjes së xhinseve të pastruara fillon procedura e grisjes duke i bërë copa të ndryshme sipas prerjes së vjetër që kishin.

Më pas vijon procesi i dizenjimit dhe skicimit të çantës që do të bëhet me pjesë të tilla

Më pas vazhdon me procesin e prerjes sipas dizajnit dhe në fund me qepjen e tij.

Puna është e ndarë mes dizenjatores Bukuroshe Sinanaj dhe dy punonjësve të

rrobaqepësisë.

## Këshilla/sugjerime për aktivitetin

*Qepja e cantave xhins është bërë nga pjesë të ndryshme të palëve të xhinseve, gjë që i jep vecanti secilës prej tyre. Detaje të tjera që i japin produktit specialitetin e tij është se ai mund të qepet ose me dorë ose me makinë qepëse. Mund të zbukurohet edhe me lule apo zbukurime të tjera të marra nga rroba të tjera të përdorura. Në rastin tonë, nuk janë përdorur detaje të tilla.*

*Pjesëmarrësit mund ta sjellin materialin nga dollapi i tyre në mënyrë që faza e grumbullimit dhe e pastrimit të mund të anashkalohej gjatë seminarit.*

*Si trajner, për të zbatuar këtë aktivitet, sugjerohet që të keni 2 persona me të cilët mund të punoni si asistentë (mund të jenë pjesëmarrës nga grupi), në mënyrë që të mund ta demonstroni procesin që ne hapat e pare.*

## NEVOJA

- Nevoja Personale - duke bërë çanta pazari nga xhinset e përdorura dhe duke reduktuar përdorimin e qeseve plastike.

- Nevoja mjedisore - ky aktivitet është tërësisht miqësor me mjedisin dhe redukton mbeturinat në dy drejtime: Redukton mbetjet e xhinseve, duke i ripërdorur dhe ricikluar, dhe redukton përdorimin e qeseve plastike.
- Nevoja shoqërore - Individët e përfshirë në këtë projekt do të ndihmojnë në ndërgjegjësimin e një pjese të shoqërisë, duke filluar nga familja, miqtë, të afërmit e tyre, etj.
- Nevoja alternative - zëvendësimi i qeseve plastike mund të bëhet edhe nga canta me materiale të tjera si dok, pambuk etj.

## PROJEKTI (Fazat)

### Nisja – Për të filluar:

- Kërkohen të gjitha mjetet dhe materialet e përshkruara
- Pjesëmarrësit duhet të jenë në grupe prej 2 ose 3 vetash
